

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DHE I DËLORË PËR PRAVOSNAŽNIN
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC,

NË EMËR TË POPULLIT

Më
Data

20. 09. 2018

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I
 PËRGGJITHSHËM PENAL,** me gjyqtarin Ilir Bytyqi dhe me procesmbajtësen Mimoza

Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], Komuna Shtime, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nënpar. 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.371-1/2012, dt.26.02.2018, PP/II.nr.510-5/18, dt.27.02.2018, PP/II.nr.1917-7/15, dt.08.11.2015, PP/II.nr.1151-7/2017, dt.05.09.2017, PP/II.nr.1915-7/15, dt.01.04.2016, PP/II.nr.1921-7/15, dt.12.04.2016, PP/II.nr.1932-8/15, dt.12.04.2016, PP/II.nr.1934-8/15, dt.12.04.2016, PP/II.nr.1935-7/15, dt.04.04.2016, PP/II.nr.1938-8/15, dt.04.04.2016, PP/II.nr.1939-7/2015, dt.12.04.2016 dhe PP/II.nr.2210-7/16, dt. 26.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, ekspertit të forenzikës psikiatrike - psikiatrit Dr. [REDAKTUAR] të dëmtuarve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe të pandehurit [REDAKTUAR] me av. mbrojtës [REDAKTUAR] i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 25.05.2018, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 14.06.2018 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] me vendbanim në Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mban nr. personal [REDAKTUAR]

I

ËSHTË FAJTOR

1. Me datë 30.01.2018, rreth orës 20:45, në rrugën “Rexhep Selimi”, konkretisht në parkingun e Marketit “Eliab”, në Ferizaj, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme, vetit t’i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, kishte hyrë në automjetin e markës “Audi”, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] pronë e tani të dëmtuarit [REDAKTUAR] ku në sirtarin e veturës në pjesën e përparme kishte marrë para në vlerë 8.700 Funta /tetëmijë e shtatëqind/, ku pas sekuestrimit nga ana e policisë të njëjtat ju kanë kthyer të dëmtuarit.
2. Me datë 24 Janar 2018, rreth orës 00:30h, në parkingun e banesave të solidaritetit në Rr.”Ramadan Rexhepi”, në Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ka tentuar të kryej vjedhjen në dëm të të dëmtuarit [REDAKTUAR], në atë mënyrë që nga vetura e tij e markës “Mercedes CDI” me tabela regjistrimi [REDAKTUAR], e cila ka qenë e parkuar dhe jo e mbyllur pasi ka hyrë brenda duke e demoluar, pas një informate nga një dëshmitar një patrullë policore në vendngjarje e kanë kapë në flagrancë.
3. Me datën 01.07.2015, rreth orës 02.58 në fshatin Vojnovc, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit ndërmerre veprime ashtu që fillimisht hapë derën e dyqanit tregtar NTP [REDAKTUAR], fillimisht hapë derën e Marketit me mjet të përshtatshëm pajser duke këputur drynin dhe më pas hynë në Market, mirëpo për një moment aktivizohet alarmi ashtu që i dyshuari ik nga vendi pa marrë asgjë duke shkaktuar vetëm dëm material vlerë të pacaktuar.
4. Me datë 19 Janar 2016, rreth orës 16:45h, në parkingun e Hib Petrol, në Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ka kryer vjedhje në dëm të dëmtuarit [REDAKTUAR] në atë mënyrë që nga vetura e tij e markës “Mercedes”, me tabela regjistrimi [REDAKTUAR], e cila ka qenë e parkuar dhe jo e mbyllur me çelës ka vjedhur një radio kasetofon të markës JVS si dhe 9 euro para të gatshme, duke i shkaktuar kështu dëm material të dëmtuarit në shumë të përgjithshme prej 59 euro.

me të cilën kreu veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par. 2 nënpar. 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 327 dhe neneve 2, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 51, 73 dhe 74 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 /një/ Viti e 3 /tre/ Muaj, të cili dënim do të vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

dhe

- Dënim me gjobë në lartësi prej 500 Euro /pesëqind/, të cilin dënim do të paguani në afat prej 30 ditëve pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Në dënimin e shqiptuar me sipër i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.01.2018 deri më 28.02.2018.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro, do të vuaj 1 /një/ ditë burgim.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 60 Euro /gjashtëdhjetë/, dhe shpenzime të procedurës shumën prej 50 Euro /pesëdhjetë/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë), brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Të dëmtuarit: [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr. [REDAKTUAR] në Ferizaj, [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr. [REDAKTUAR] në Ferizaj, [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr. [REDAKTUAR] në Ferizaj, realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

II

Konform nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK-së

REFUZOHEN AKUZAT

I akuzuari [REDAKTUAR]

1. Me datë 26.06.2015, rreth orës 01:00 pas mesnate i pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani tregtar NTP [REDAKTUAR] i cili gjendet në Fshatin Godanc, Komuna e Shtimes pronë e [REDAKTUAR] i pandehuri kishte thyer drynin e dyqanit dhe ishte futur brenda dhe kishte vjedhur cigare të llojeve të ndryshme dhe para të gatshme sipas të dëmtuarit.
2. Me datë 18.06.2015 i dyshuari i lartëcekur me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani tregtar [REDAKTUAR], pronë e [REDAKTUAR] i cili gjendet në fshatin Caralevë, Komuna e Shtimes, i dyshuari kishte këputur me forcë dy drynat e dyqanit dhe kishte hyrë në dyqan dhe nga aty kishte vjedhur para të gatshme në shumë prej 30€.
3. Me datë 18.06.2015 i dyshuari i lartëcekur me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani tregtar NTP "[REDAKTUAR]", pronë e [REDAKTUAR] i cili gjendet në Fsg. Caralevë, Komuna e Shtimes, i dyshuari kishte këputur me forcë drynin e dyqanit dhe kishte hyrë brenda në dyqan dhe nga

aty kishte vjedhur para të gatshme 13€ si dhe cigare të llojeve të ndryshme në vlerë prej 61€.

4. Me datë 26.06.2015 i pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani tregtar NTP [REDAKTUAR] i cili gjendet në fshatin Rashinc, Komuna e Shtimes pronë e [REDAKTUAR] i pandehuri kishte thyer drynin e dyqanit dhe ishte futur brenda dhe kishte vjedhur para të gatshme në vlerë prej 30€ dhe një çantë dore.
5. Me datë 18.06.2015 i pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani [REDAKTUAR] pronë e [REDAKTUAR] i cili gjendet tek rrethi (te Pishat), Komuna e Shtimes, i pandehuri kishte hyrë me forcë, në dyqan dhe nga aty kishte vjedhur një arkë të metaltë në të cilën sipas të dëmtuarit kishin qenë rreth 80 Euro.
6. Me datë 26.06.2015 i dyshuari i lartëcekur me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani tregtar NTP [REDAKTUAR], pronë e [REDAKTUAR] i cili gjendet në fshatin Godanc, Komuna Shtime, i dyshuari kishte këputur me forcë drynin e dyqanit dhe kishte hyrë brenda në dyqan dhe nga aty kishte vjedhur cigare të llojeve të ndryshme me vlerë prej 30€ dhe para të gatshme në shumë prej 15 Euro.
7. Me datë 26.06.2015 rreth orës 02:30 pas mesnate i dyshuari i lartëcekur me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme kishte shkuar tek dyqani tregtar [REDAKTUAR] i cili gjendet në fshatin Petrovë, Komuna e Shtimes pronë e [REDAKTUAR] i dyshuari kishte thyer drynin e dyqanit dhe ishte futur brenda dhe kishte vjedhur cigare të llojeve të ndryshme dhe para të gatshme sipas të dëmtuarit 543 Euro.
8. Me dt.08.08.2016, rreth orës 12:45 në fsh. Vojnovc, K. Shtime, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj e që vetit ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, nga vetura e të dëmtuarit [REDAKTUAR] i cili e kishte derën e pa

mbyllur me çelës, i njëjti e çel derën e veturës dhe merr qantën në të cilën kanë qenë të holla në shumë prej 285 euro dhe menjëherë ikën nga vendi i ngjarjes.

- Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtarë sa i përket propozimeve për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, sipas numrave të lëndëve me PP.II.nr.1915-7/15 dt.01.04.2016, PP.II.nr.1921-7/15, dt.12.04.2016, PP.II.nr.1932-8/15, dt.12.04.2016, PP.II.nr.1934-8/15 dt.12.04.2016, PP.II.nr.1935-7/15, dt.04.04.2016, PP.II.nr. 1938-8/15, dt.04.04.2016, PP.II.nr.1939-7/15, dt.12.04.2016 dhe PP.II.nr.220-7/16 dt. 26.01.2017, është tërhequr nga propozimet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik respektivisht aktakuzës pasi që me rastin e administrimit të provave nuk është vërtetuar se i pandehuri i ka kryer këto vepra penale për të cilat ngarkuar.
- Të dëmtuarit: [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime, [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime, [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime, [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime, [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime, [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Shtime dhe [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Shpenzimet sa i përket pjesës II të këtij aktgjykimi bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj

gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur kundër të pandehurit [REDAKTUAR] këto aktakuzën PP/II.nr.510-5/18 i dt.27.02.2018, PP/II.nr.1917-7/15 i dt.08.11.2015 dhe PP/II.nr.2210-7/16 i dt.26.01.2017, respektivisht ka paraqitur Propozimet për Shqiptimin e Masës së Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri PP/II.nr.371-1/18 dt. 26.02.2018, PP/II.nr.1151-7/17, dt.05.09.2017, PP/II.nr.1915-7/16, dt.01.04.2016, PP/II.nr.1921-7/15, dt.12.04.2016, PP/II.nr.1932-8/15, dt.12.04.2016, PP/II.nr.1934-8/15, dt.12.04.2016, PP/II.nr. 1935-7/15, dt.04.04.2016, PP/II.nr.1938-8/15, dt.04.04.2016 dhe PP/II.nr. 1939-7/15, dt.12.04.2016, për shkak të veprave penale: vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nënpar. 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, si dhe veprës penale në tentativë vjedhje nga neni 321 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së

Bashkimi i procedurave.

Ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] janë të paraqitura të gjyqtari gjykues 12 /dymbëdhjetë/ aktakuza dhe propozime nga ana e prokurorit i shtetit, gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare por edhe me pëlqimin e prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, Av. mbrojtës [REDAKTUAR] (të caktuar sipas detyrës zyrtare) dhe vetë të pandehurit [REDAKTUAR] URDHËROJHET BASHKIMI E PROCEDURAVE PENALE sipas numrave të lëndëve të evidentuara në Gjykatë: P.nr.313/18, P.nr.362/18, P.nr.1392/15, P.nr.2209/17 P.nr.282/16 P.nr.283/16, P.nr.287/16, P.nr.288/16, P.nr.285/16, P.nr.286/16, P.nr.284/16 dhe P.nr.268/17, kundër të pandehurit [REDAKTUAR], për shkak të veprave penale vjedhje nga neni 325 par. 1, veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nënpar. 2.1 lidhur me par. 1 si dhe veprës penale në tentativë vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe në procedurën e mëtutjeshme lënda do të evidentohet sipas numrin bartës P.nr.313/2018.

Me qenë se në aktakuza bëhet fjalë për të njëjtin person, natyrën e njëjtë të veprës penale, dashja e njëjtë e kryerjes të veprës penale, objekti i njëjtë i kryesit të veprës penale, intervali kohor i përafërt si dhe për shkak të institutit edhe të ekonomizimit të procedurës penale, pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe avokatit mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare lidhur me pëlqimin për bashkim të procedurave, gjykata në

kuptim të nenit 35 par. 1 dhe 8 të KPPK, vendosi që të zhvillohet një procedurë unike në lëndët kundër të akuzuarit [REDACTED]

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues duke vepruar në këto çështje penale konform nenit 245, 246, 248 dhe e veçmas udhëzimeve nga neni 323 dhe 326 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor dhe publik me këto data 23.04.2018, 18.05.2018 dhe 25.05.2018, në të cilën prokurori i shtetit Avdullah Abedini lexoi të gjitha aktakuzat me numër të sipërcekur një nga një.

Gjyqtari i vetëm gjykues para se ti jepe fjalën të pandehurit [REDACTED] për tu deklaruar për fajësinë apo pafajësinë për të gjitha pikat e akuzave, kërkoj mendimin e ekspertit të Forenzikes Psikiatrike Dr. [REDACTED] të deklarohet në rrethana nëse i pandehuri është i aftë për tu deklaruar, kuptuar natyrën e aktakuzave: eksperti deklaroi se i ekzaminuari [REDACTED] mund të konstatojmë se aktualisht mund të marrë pjesë në këtë proces gjyqësor dhe i njëjti është i aftë për tu deklaruar dhe për tu përballur me këtë gjykim duke e përfshi edhe natyrën e secilës aktakuzë dhe masë për propozimet që janë paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të dt. 23.04.2018 i akuzuari [REDACTED] është deklaruar: i ka m kuptuar aktakuzat të lexuar nga prokurori i shtetit, sa i përket veprës penale sipas PP.II.nr.1151-7/2017 dt. 05.09.2017 është e vërtetë se unë e kam bërë dhe si të tillë e pranoj, po ashtu edhe veprën penale sipas aktakuzës PP.II.nr. 371-1/2018 të dt. 26.02.2018 është e saktë dhe e vërtetë se unë e kam bërë, po ashtu edhe për veprën penale sipas aktakuzës PP.II.nr. 1917-7/2015 dt. 08.11.2015 e kam bërë, po ashtu edhe veprën penale sipas aktakuzës PP.II.nr.510-5/2018 dt.07.02.2018 i pranoj si të tilla sipas gjitha pikave.

Mbrojtës i te akuzuarit [REDACTED] Av. [REDACTED] në lidhje me veprat për të cilat vetë i pandehuri deklarohet, japë këtë mendim: nga natyra e veprave të cilat i pandehuri i ka kryer shihet se i njëjti të gjitha veprat të cilat i ka pranuar kanë të bëjnë me vjedhje në automjete, që kanë një lidhshmëri në mes vete, kurse veprat të cilat i pandehuri nuk i ka pranuar kanë të bëjnë me thyerjen e dyqaneve tregtare e të cilat i pandehuri deklarohet se nuk i pranon e ato janë 8 aktakuza të ngritur ndaj të pandehurit. Nga mendimi i ekspertit shihet se i pandehuri mund ti kuptoj veprimet në kohën e kryerjes së veprave penale dhe mund të

përcjell gjykimin si dhe ti propozoj gjykatës katër veprat penale të cilat në mënyrë vullnetare i pandehuri i ka pranuar edhe pas konsultimit me mua, i propozoj që të njëjtat të pranohen.

Eksperti i Forenzikës në lidhje me pranimin fajësisë për veprat penale që i akuzuari e pranoi fajësinë deklaroi: deklarata e të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë duhet të merret si e saktë, i akuzuari është i aftë të kuptoj pasojën që janë shkaktuar dhe ajo që mund të vijë, me arsytim se i akuzuari di të bëjë dallimin në mes të mirës dhe të keqes dhe në këtë fazë të procedurës për këto katër vepra që u deklarua edhe në prezencën e avokatit, mendimi im është që të pranohet fajësia pasi që sipas ekzaminimit psikiatrik i akuzuari është i përgjegjshëm për veprat penale që i janë ngarkuar.

Mendimin i ekspertit të forenzikës psikiatrike, Dr. [REDAKTUAR] në bazë të dokumentacionit që posedon lënda dhe atë Ekspertizën Psikiatrike nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë të dt. dt.07.08.2017 dhe 21.02.2018 dhe në bazë të bashkëbisedimit të drejtpërdrejtë në seancë, konstatoj se [REDAKTUAR] është konstatuar çrregullim mendor i cili quhet retardim i lehtë mendor. Në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve mendore ky çrregullim kodohet me shifra F-70.0, (ICD-10), ky çrregullim karakterizohet me gjendje të mos zhvillimit të plotë psikik, karakterizohet me deficite të disa aftësive (shkathtësive) që fitohen gjatë periudhës së rritjes dhe zhvillimit të individit, të cilat në nivel të përgjithshëm kontribuojnë në funksionimin normal të individit, aspektin të cilat më së tepërmi atakohen është aspekt i inteligjencës siç është kognicioni (njohja), të folurit, emocionet dhe sjelljet. Shumica e personave me këtë çrregullim arrijnë të kujdesen për veten në aspektin e të ushqyerit, veshmbathjes dhe kontrollimit të nevojave fiziologjike. Duke marrë parasysh shkresat lëndës dhe deklaratat e të ekzaminuarit tonë, komisioni ka konstatuar se [REDAKTUAR] në kohën e kryerjes së kësaj vepre ka pasur një zvogëlim të aftësisë së kontrollit të veprimeve, por ky zvogëlim ka qenë në një shkallë jo esenciale që do të thotë se aftësia e tij për të kontrolluar veprimet e tij ka qenë e dëmtuar por jo në mënyrë aq të madhe sa për të përjashtuar nga përgjegjësia, i akuzuari është i aftë të kuptoj veprimet dhe sjelljet e tij në kohën e kryerjes së veprës penale që do të thotë nuk e përjashton përgjegjësia penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 23.05.2018, respektivisht mbrojtjes së të pandehurit [REDAKTUAR] se i njëjti ka deklaruar se: po është e vërtetë se në veturën "Audi" i kam marrë 8700 funta të Anglisë, vetura ka qenë jo e mbyllur me çelës, e pash që dera nuk ishte e mbyllur me çelës dhe unë e hapja dhe hyra në të, gjatë kontrollit nga ana e

pasagjerit në fijos ishin paratë dhe të gjitha i kam marrë dhe pas disa orëve policia ka ardhur në fshatin tim në [REDAKTUAR] më ka zënë, gjatë kontrollit më janë gjetur paratë në jaknen time dhe mi kanë konfiskuar, ndërsa për rastin e vjedhjes në dyqanin NTP [REDAKTUAR], nuk më kujtohet data kur e kam kryer dhe nuk më kujtohet se me çfarë e kam hapur lokalin por e di se e kam këputur drynin dhe kam hyrë në Market dhe aty sapo hyra është ndezur alarmi dhe unë pastaj kam ikur nga vendi i ngjarjes pa marrë asgjë. Po ashtu edhe sa i përket rastit tek HIB Petrolli edhe në polici edhe në gjykatë e kam pranuar veprën penale se e kam kryer, ku nga një veturë e markës "Mercedes" e cila ishte e parkuar aty po ashtu nuk ishte e mbyllur me çelës e kam vjedhur një radio kasetofon dhe 9 /nëntë/ euro. Ndërsa sa iu përket vjedhjes në rrugën "Ramadan Rexhepi" në Ferizaj, në parkingun e banesave të Solidaritetit kam provuar që nga një veturë Mercedes CDI, ngjyrë e zezë të kryej vjedhjen, e cila veturë po ashtu nuk ishte e mbyllur, kam kontrolluar brenda në veturë dhe sirtar mirëpo nuk kam mundur të gjej asgjë, Policia shumë shpejt kanë arritur dhe më kanë kapur në vend të ngjarjes dhe më kanë dërguar në Stacion për të dhënë deklaratë.

Po ashtu i pandehuri një pjesë të mbrojtjes e paraqet edhe për veprat penale të voilat nuk i ka pranuar si është rasti te vjedhja në Fsh. Godanc, në shitoren e të dëmtuarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], unë nuk e kam bërë këtë dhe po ashtu për të gjitha veprat që më ngarkojnë sikur tekë rasti [REDAKTUAR] që e dëgjuam sot në sallë, po ashtu edhe këtë të rasti i [REDAKTUAR], e gjithashtu sa i përket shitores së [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], unë nuk qëndroj pranë këtyre veprave penale dhe për të njëjtat kam mësuar në këtë procedurë, sot e tutje me bindje të plotë e njoftoj gjykatën se as nuk e di se ku ndodhen këto shitore të supozuara se unë i kam kryer, andaj më tepër për të gjitha këto vepra që nuk i kam pranuar nuk kam asgjë për të shtuar më shumë, (prokurori i shtetit ka heqë dorë nga këto vepra penale që i përshkuan i akuzuari, janë po ato në dispozitiv të aktgjykimit refuzues).

Vlerësimi i pranimit të fajësisë së të akzuarit

Gjykata, pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ekspertit të forenzikës, avokatit të të pandehurit dhe vetë të pandehurit, në lidhje me pranimit të fajësisë sipas lëndëve P.nr. 313/18, P.nr.2209/17, P.nr. 1392/15 si dhe P.nr. 362/18, për veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nën par 2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe dy veprat penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale vjedhje në tentativë nga neni 325 par.1 lidhur

me nenin 28 të KPRK-së, vendosi me aktvendim që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit [REDAKTUAR] konform nenit 248 par. 4 të KPPK-së.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, përkatësisht: Raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike dt. 21.02.2018, Raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike dt. 21.02.2018, Raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike dt. 07.08.2017, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dt. 30.01.2018, Video Incizimet CD dt. 31.01.2018, Kuponi i Këmbimores "Euro-Eki" i dt. 30.01.2018, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të konfiskuara dt. 31.01.2017, fotografitë e vendit të ngjarjes dhe mjeteve të sekuestruara, Raportet e Oficerit nr. rasti 2016-CF-0130 i dt. 19.01.2016, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 24.01.2018, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 01.07.2015, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 19.01.2016 si dhe deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 31.01.2018.

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës të cilat janë në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Rikualifikimi juridik i veprave penale nga ana e gjykatës sipas detyrës zyrtare

Gjykata, duke vepruar në bazë të kompetencave të veta ndaj të pandehurit [REDAKTUAR], bëri rikualifikimin juridik të veprave penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nenpar. 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe veprës penale në tentativë vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 2 nenpar. 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me qenë se është institut që shkon në favor të të pandehurve për faktin se ligjet pozitive ju garanton këtë dhe përmbushën kushtet nga neni 81 par.1 nenpar.1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 lidhur me par. 4 të KPRK-së, nëse vepra penale në vazhdim përfshin forma më të rënda dhe të lehta të të njëjtës vepër konsiderohet se vepra penale në vazhdim është kryer në formën më të rëndë, andaj rrjedhimisht për të gjitha veprat penale do të shqiptohet vetëm një dënim në vend të caktimit të disa dënimeve pastaj dënimin unik.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Në këto rrethana, e ndodhur përpara faktit të parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave të marra në gjykim të kësaj qeshje, gjykata çmon se me veprimin e tij, janë prezent elementet e kundërligjshme të veprës penale të cili kanë prekur drejtpërdrejt pasurinë e huaj pronë e luajtshme të të dëmtuarve të sipërcekur, pra të drejtën e pronësisë së tyre të mbrojtur nga legjislacioni penal, i pandehuri [REDAKTUAR] ka konsumuar veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nënë par.2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Konkretisht, sa i përket objektit të veprës penale, veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri [REDAKTUAR] kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen dhe paprekshmërisë e pronës dhe të drejtave pasurore të personave fizike e juridike nga veprimet kriminale të mbrojtura nga legjislacioni ynë penal, dhe si të tilla paraqesin rrezikshmëri shoqërore.

Nga ana objektive, kjo vepër është kryer nga i pandehuri [REDAKTUAR] me veprime aktive të kundërligjshme, duke i ju vjedhur fshehurazi të dëmtuarve të sipërcekur sendet e përshkruara si në pikën I, II, III dhe IV të pjesës fajësuese të dispozitiv.

Nga ana subjektive këto veprime janë kryer nga i pandehuri [REDACTED] dhe me dashje direkte dhe me qëllimin të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, pasi i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre, por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, ç'ka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprave penale.

Gjykata, vlerësoj mendimin dhe konstatimin e Institutit të Forenzikes Psikiatrike se teke i pandehuri është konstatuar çrregullim mendor i quajtur retardim i lehtë mendor dhe në momentin e kryerjes së veprës penale aftësia e tij mendore ka qene e zvogëluar në shkallë JOESENCIALE, i pandehuri mund të marre pjesë në seanca gjyqësore dhe se e kupton aktakuzën, mirëpo vlerësuar në kuptim të nenit 18 par. 2 të KPRK-së, personi i cili ka kryer veprën penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimit ose mosveprimit të tij ka qene ESENCIALISHT E ZVOGLUAR, dhe se personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, andaj edhe i shqipton dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par. 2 nënpar. 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, meqë me datat, vendet dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin të këtij aktgjykimi i akuzuari me dashje direkte ka konsumuar elementet e veprave penale të lartshënuar.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron: pas administrimit të provave në shqyrtime gjyqësore kundër të pandehurit [REDACTED] i akuzuari për veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së si dhe pas dëgjimit të ekspertit psikiatër Dr. [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor të dt. 23.04.2018 lidhur me gjendjen e aftësisë mendore të të pandehurit, i njëjti ka konstatuar dhe ka dhënë mendimin profesional se i pandehuri është i aftë të marrë pjesë në gjykim, të deklarohet si dhe të kuptoj veprimet e tij. Po ashtu nga raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzike QKUK në Prishtinë të dt. 07.08.2017, të punuar nga Dr. [REDACTED] Dr. [REDACTED] dhe Dr. [REDACTED] psikiatër, kanë dhënë mendimin profesional lidhur me gjendjen e aftësisë mendore për të pandehurin [REDACTED] se në

kohën e kryerjes së veprave penale aftësia e tij mendore e të kuptuarit dhe kontrollës së veprimeve të tij për veprat të cilat i ka kryer ka pasur aftësi të zvogëluar në shkallë joesenciale si dhe bazuar edhe në ekzaminimin klinik të bërë nga nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike e dt. 06.02.2018, i bërë nga grupi i ekspertëve Dr. [REDAKTUAR] Dr. [REDAKTUAR] dhe Dr. [REDAKTUAR], i pandehuri në momentin e kryerjes së veprës penale aftësinë e tij mendore dhe të kuptuarit dhe kontrollës së veprimeve të veta për veprën të cilën ngarkohet ka qenë e zvogëluar në shkallë joesenciale si dhe i pandehuri [REDAKTUAR] mund të mbrojë veten dhe mund të konsultohet me persona të tjerë dhe mund të marr pjesë në seanca gjyqësore dhe është i aftë të përballet me gjykim. Ndërsa sa i përket intervalit kohor të veprave penale të kryera kjo është vërtetuar nga Dr. Eksperti [REDAKTUAR] se sëmundja e të ekzaminuarit [REDAKTUAR] është kronike e përhershme pavarësisht se si i ekzaminuari mund ta ketë kryer veprën penale në vitin 2015, 2016, 2017 apo 2018 si dhe duke iu referuar edhe ekzaminimit të fundit të dt. 21.02.2018, nuk ka ndryshuar gjendja e shëndetit mendor ndaj të ekzaminuarit [REDAKTUAR] andaj në bazë të këtyre nuk përjashtohet nga përgjegjësia penale. Pas ekspertizave të lartëcekura mbi gjendjen shëndetësore mendore të të pandehurit në kuptim të nenit 18 par.2 të KPRK-së, propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri Nr. PP.II.nr. 1151-7/17 e dt. 05.09.2017 dhe PP.II.nr. 371-1/18 dt. 26.02.2018, ndryshohen dhe tutje duhet të jetë aktakuzë, dhe si të tilla mbes në tërësi pranë këtyre aktakuzave pasi që i pandehuri në shqyrtimet gjyqësore i ka pranuar këto vepra penale duke përshkruar mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së këtyre veprave penale.

Av. mbrojtës i të pandehurit [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare deklaron: sa i përket lëndëve ku prokuroria ka bërë propozim për shqiptimin e masës së detyrueshme psikiatrike në liri ku gjatë kësaj seance e ndryshon në aktin Aktakuzë dhe atë për dy lëndë që janë në tentativë si të pakryera ku vepra e përshkruar është vjedhje të njëjtën e ka pranuar mirëpo e njëjta konsideroj se është në tentativë sepse nuk ka arritur i mbrojturi im as të largohet nga vendi i ngjarjes edhe vepra tjetër e cila ka qenë Aktakuzë PP.nr. 1917-7/15 dt. 08.11.2015, me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së konsideroj se edhe këtu është tentative edhe Aktakuza PP.nr.510-5/18 dt.27.02.2018 e kualifikuar vjedhje në tentativë nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, nuk e kundërshtoj. Kundërshtimi im mbështetet në kualifikimin të cilin tani prokurori i shtetit i bëri nga propozimi për shqiptimin e masës psikiatrike në liri në Aktakuzë me arsyetim të bazuar në raportin e forenzikës psikiatrike të dt. 21.02.2018, konsideroj se i njëjti përshkruan

gjendjen e të pandehurit ku thotë se shumica e personave me retardim në fjalë arrijnë që të kujdesen për vete si për ushqim, veshmbathje dhe kontroll të nevojave fiziologjike, nëse lëshohemi me këtë konstatim kuptojmë se i pandehuri nuk mund të kujdeset për veprime tjera por vetëm për ato të jetës së domosdoshme me vet faktin që i njëjti është i sëmurë kronik, kuptohet se kjo sëmundje nuk është e kalueshme por është e përhershme dhe me këtë besoj fuqishëm se i pandehuri nuk është i përgjegjshëm dhe se veprat të cilat i ka bërë i ka bërë si i papërgjegjshëm. Kërkoj nga Gjykata që të marrë parasysh sëmundjen e tij kronike dhe më tej ti shqiptoj të pandehurit një masë për trajtim të detyrueshëm psikiatrik të tipit të hapur, që si rrethanë lehtësuese të merr gjendjen e tij shëndetësore, kushtet e rënda ekonomike dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë dhe vullnetin e tij për të bashkëpunuar me gjykatën.

I pandehuri [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare deklaroi: e mbështes në tërësi Avokatin tim mbrojtës në fjalën e tij përfundimtare si dhe i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe premtimin tim që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, mbi bazën e këtyre i propozoj gjykatës të më shqipton një dënim sam ë të butë.

Matja e dënimit - Përcaktimi i dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit për të akuzuarit, pati parasysh të gjitha rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit të parapara në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së.

Për të akuzuarin [REDAKTUAR] si **rrethana veçanërisht lehtësuese**, pati parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale (për veprat penale që kishte bazë), ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprat e kryera penale, nuk ekzistojnë të dhëna se më parë ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, është i gjendjes së varfër ekonomike, si dhe në veçanti se i njëjtë vuan nga një çrregullim i lehtë mendor F-70 (ICD-10), ndërsa si **rrethana rënduese** për të akuzuarin gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së këtyre veprave penale të vrazhdë, ku i akuzuari paraprakisht me paramendim dhe me një përgatitje bukur të mirë, duke e shfrytëzuar në një periudhë kohore në vazhdimësi ka kryer disa vjedhje të gjitha për kontinuitet, me të vetmin qëllim të përfitoj dobi pasurore dhe materiale. Karakteristikat e tij

personale edhe përkundër këtyre veprave penale i njëjti pritet të gjykohet edhe për disa vepra penale të bëra menjëherë pas ndërprerjes së paraburgimit me dt. 28.02.2018, të natyrës së njëjtë (vjedhje të rëndë dhe vjedhje), nëse i referohemi verifikimit të të kaluarës kriminale të bashkangjitur në shkresa shifet qartë se dyshohet për rreth 60 /gjashtëdhjetë/ vepra penale, vendosmërinë për ti kryer këto vepra penale edhe përkundër premtimit se nuk do të përsërit veprat penale. Andaj mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin e lartëcekura i shqiptoi dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, me bindje se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, që të parandaloj të akuzuarin në të ardhmen në kryerjen e veprave penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij, (preventiva speciale) dhe të përmbajë personat e tjerë në kryerjen e veprave të tilla të rrezikshme, pra do t'i shërbej preventives gjenerale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe me autoret të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Llogaritja e paraburgimit, shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike.

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim siç parashihet në nenin 83 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën e përgjithshme prej 60 euro, bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-se, e cila shumë është caktuar duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale dhe gjendjen ekonomike të akuzuarit.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 /pesëdhjetë/ €, në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

II

Sa i përket pjesës së dytë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues, sa i përket propozimeve për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, sipas numrave të lëndëve me PP.II.nr.1915-7/15 dt. 01.04.2016, PP.II.nr. 1921-7/15, dt. 12.04.2016, PP.II.nr. 1932-8/15 dt. 12.04.2016. PP.II.nr. 1934-8/15, dt. 12.04.2016, PP.II.nr. 1935-7/15dt. 04.04.2026, PP.II.nr. 1938-8/15, dt.04.04.2016, PP.II.nr. 1939-7/15, dt. 12.04.2016 dhe PP.II.nr.2210-7/16, dt.26.01.2017, Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare është tërhequr nga këto respektivisht ndaj të pandehurit Qemajl Mehmeti pasi që me rastin e administrimit të provave nuk është vërtetuar se i pandehuri i ka kryer këto vepra penale për të cilat është akuzuar.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-ës shpenzime sa i përket pjesës nën II të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.313/18, me datë 14.06.2018

B. Profesional
Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.